



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2019:290724

Datë: 21.08.2020

Numri i dokumentit: 01073190

P.nr.304/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjyquese Sabrije Rraci, në çështjen penale kundër të pandehurit: E. (A.) M. për shkak të veprës penale: Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me paragrafin 6 dhe par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.Nr:1533/19, të dt: 12.12.2019, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurorit të Shtetit: Arben Hoti nga Prokuroria Themelore në Pejë, pandehurit: E. M. dhe të autorizuarit të tij Av. Gëzim Baloku nga Peja pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më dt. 11.08.2020, në të njëjtën ditë shpalli aktgjykimin, kurse me datën: 20.08.2020e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: E.M., i biri i A.it , dhe i nënës F. e gjinisë A., i lindur me dt...., në Gjakovë, absolvent i Fakultetit të Mjeksisë beqar, i gjendjes se Mesme ekonomike, identifikohet me nr. personal, shqiptare shtetas i Republikës se Kosovës, mbrohet ne liri.

ËSHTË FAJTORË

SEPSE:

Me datë:21.05.2019 rreth orës 19:05 në rrugën magjistrale Pejë-Prishtinë, në fsh. Klinë, nga pakujdesia dhe duke shkelur nenin 53 par.1 të Ligjit nr.05/-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, rrezikon jetën e njerëzve dhe me këtë u shkakton lëndime të rënda trupore të tjerve dhe atë të dëmtuarve J. K. dhe R. Q. në atë mënyrë që, derisa i pandehuri ishte duke qarkulluar me automjetin e tij të markës ‘VW Caralevellë’ me targa ... në rrugën e lartëcekur në drejtim të Prishtinës, fillon tejkallim të pasigurte dhe duke mos përshtatur shpejtësinë e humb kontrollin mbi automjet duke dalë jashtë rrugës në të majtë dhe e godet me pjesën ballore bregun e dheut me ç’rast rrokulliset dhe nga kjo lëndime të rënda pësojnë J. K. dhe R. Q. ndërsa lëndime të lehta E. R. dhe N. Y., të cilat ishin pasagjere në automjetin e të pandehurit,

Me çka ka kryer veprë penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 e lidhur me paragrafin 6 dhe par 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4,7,17,41, 46 dhe 73 si dhe nenit 378 par.8 e lidhur me par.6 dhe par të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së :

G J Y K O N

Me dënim Burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, duke e llogaritur kohën e kaluar në arrest shtëpiak prej 1 (një) muaji.

Gjykata me pëlqimin e të pandehurit dënimin me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i'a shëndërroi **NË DËNIM ME GJOBË shuma në vlerë prej 1500 (njëmijë e pesëqind) Euro**, pasi aktgjykimi të bëhet i plotëfuqishëm.

DËNIM PËOTËSUES: Konform nenit 62 par.2.5 ti merret leja e vozitjes për një 1 (një) viti.

II. OBLIGOHET I PANDEHURI që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën në vlerë prej 20 (njëzet) €, për shpenzime të ekspertizës së komunikacionit 40 (dytë) Euro, për shpenzime të ekspertizës mjeko ligjore 30 (tridhjetë) €, si dhe shpenzimet për kompensim të viktimave të krimit 30 (nëntëdhjetë) €, gjithsejtë 120 (njëqindë e njëzet) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. UDHËZOHËN: Pala e dëmtuar R. (J.) Q. nga Gjakova, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritë aktakuzë me, PP.II.Nr.1533/19 të dt.12.12.2019, ndaj të akuzuarit E. nga fsh., për shkak të veprës penale: Rrezikim i trafikut publik nga neni 378, par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt: 11.08.2020 gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit: Arben Hoti nga Prokuroria Themelore në Pejë, i cili bëri leximin e aktakuzës ku të pranishëm ishte i akuzuari, E. M.. dhe përfaqësuesi i të pandehurit Av. Gëzim Baloku.

I pandehuri, në seancën e shqyrtimit fillestar, është deklaruar se e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe ka shtuar se kërkoj falje dhe premtoj se një gjë e tillë nuk do të përsëritet, meqë është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj dënim më të butë.

Prokurori i Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë, në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë pasi që pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije të plotë për pasojat e pranimit të fajësisë, pasi që ky pranim është bërë konform dispozitave të KPPRK-së, neni 248.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht, me liri të plotë nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga Prokurorja e Shtetit.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht Prokurores së Shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj Gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata u mbështetë edhe në provat materiale siç janë: Pprocesverbalin mbi vend shikimit e aksidentit me nr. të rastit DR- 3004-261-19 i datës 02.07.2019, Raporti i aksidentit nr. 0295111 e dt. 21.05.2019, Deklarata e të dyshuarit E. M. e dhënë në polici me dt. 21.06.2019, raporti për konsulta për N. Y. nr. 2730, Raporti mjekësor për të pandehurin E. M. nr. 8815 e lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë Reparti i emergjencës me dt. 21.05.2019, fletëlshimi me nr. të historisë 4067 e dt. 23.05.2019 për të pandehurin E. M., raporti nga konsulta për E. M. nr. 2731 Fletëlshimi me nr. të historisë 3520 e dt. 28.05.2019 për të dëmtuarën R. Q., si dhe raporti mjekësor nr. 8813 për të njëjtën, Raporti mjekësor për E. R. nr. 8812 e lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë-Reparti i Emergjencës, me dt. 21.05.2019, Raporti mjekësor për N. Y. nr. ... e lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë, Reparti i Emergjencës me dt. 21.05.2019, Akt ekspertimi mjeko-ligjor me nr. ref. 27.07.2019, Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit E. M., dt. 08.08.2019, Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së të dëmtuarës R.Q., dt. 09.08.2019, Mendimi i ekspertit të komunikacionit S. B. dt.09.08.2019, akt-ekspertimi mjeko-ligjor dt. 29.11.2019 me nr. Ref. PE-86, si dhe skica dhe fotografitë e vendit të ngjarjes.

I pandehuri deklaroi se rasti që më ka ndodhur ka qenë pa dashje dhe e ndjej veten fajtor, mirëpo mua më vjen shumë keq nga palët e dëmtuara, unë qdo herë kam qenë pranë tyre me familjen time në Spital, pasi që babin dhe vëllaun i kam mjek, për qka ka pasë nevojë prindërit e mi ua kan siguruar palëve të dëmtuara. Ne njhemi për më shumë se 10 vite me familjen e tyre, ku edhe tani kemi marrëdhënie të mira.

Mbrojtësi i të pandehurit Av. Gëzim Baloku deklaroi se meqenëse i pandehuri e pranoi fajsinë, si rrethanë lehtësuese kërkoi që të merret edhe mosha e re e të pandehurit, si dhe faktin se i njëjti është absolvent i Fakultetit të mjekësisë, dhe një dënim i rëndë kishte me pengë në karrierën e ardhshme, poashtu si rrethanë lehtësuese është kujdesi i familjes së tij ndaj të dëmtuarave, si dhe edhe rrethanën se të njëjtat nuk i bashkangjiten ndjekjes penale.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në llojin dhe masën e dënimit, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i pandehuri, gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ishte i sinqertë gjatë gjykimit, dhe ndien shumë, keqardhje për veprën e kryer, poashtu si rrethanë lehtësuese merret mosha relativisht e re si dhe sjellja korrekte, faktin se është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin, premtimin se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe nuk do të bie ndesh me ligjin.

Ndërsa duke e marrë parasysh **shkallën e përgjegjësisë penale rrethanë** rënduese gjykata **nuk gjeti, mirëpo** pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të palëve të dëmtuara si dhe pakujdesinë e kryerjes së veprës penale, në këtë çështje penalo-juridike.

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit E.M qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 e lidhur me paragrafin 6 dhe par 1 të KPRK-së.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pajtim me nenin 38 të KPRK-së, si dhe në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Gjykata gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur, duke marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, aprovoj aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë, për dhënien e dënimit meritor, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform dispozitave ligjore të nenit 453 par.1 të KPPRK-së, obligohet i pandehuri që të kompensoj paushallin gjyqësor, shpenzimet e ekspertizës së komunikacionit dhe shpenzimet e ekspertizës mjeko ligjore si dhe si dhe shpenzimet për kompensim të viktimave të krimit u muar konform Qarkores për zbatimin e ligjit nr.05/L-036.

Konform dispozitave ligjore të nenit 463 të KPPRK-së, u vendos për kërkesën pasurore juridike duke udhëzuar palët e dëmtuara që kompensimin e dëmit ta realizojnë në kontest të rregullt civil.

Andaj nga arsyet e theksuara me lartë, dhe konform dispozitave ligjore të nenit 25 par.2, 26 par.2, 297, 365 dhe 470 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA KLINË
P.nr.304/2019 më dt: 18.08.2020

Sekretare Juridike
Shere Desku

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet
Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e
pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në
Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.